



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Projektet Sociale viti 2025

Financim për shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga shoqata “Opera della Providenza Madoninnina fond I kushtëzuar I Ministrisë së Shëndetësisë”

Këshilli I Qarkut Shkodër për vitin 2025 në VKQ nr:26 datë 20.12.2024, neni 77 të Ligjit nr.139/2015. Për vetëqeverisjen vendore. Ligji nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2025” pika 1,2 të nenit 21 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për personat me aftësi të kufizuar të grup moshës 30-60 vjeç, në shtëpinë “Facibeni”, ofruar nga shoqata “Opera della Providenza Madonina della Grappa”, në programin 10430, Art 6060000, shpenzime korente, shumën 5,552,000 lekë.

Shoqata “Opera della Providenza Madonina della Grappa”, ushtron aktivitetin e saj prej 27 vitesh dhe strehon persona me aftësi të kufizuar të grup moshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritetit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për personat me aftësi të kufizuar.

Shërbimet që ofrohen në këtë qendër janë:

- Shërbime rrezidenciale
- Shërbime mjekësore
- Shërbim psiko-social
- Aktivitete sociale, kulturore, vizita
- Shërbime sanitare

Qendra ditore 'Buzëqeshja e moter Lezes' ofruar nga shtëpi-familje Madonnina della Grappa:

Qendra ditore "Buzëqeshja e motër Lezes" ofron shërbim për personat me aftësi të kufizuar të moderuar, për moshat 20-50 vjeç shërbim I cili ju shtua rrjetit të shërbimeve sociale në qytetin Shkodres në perjullen Shkurt 2024.

Qëllimi është garantimi I cilësisë së jetës në plotësimin e nevojave dhe kërkesave të personave me aftësi të kufizuar, mbështetje në procesin e reabilitimit social, përfshirja e familjes si pjesë integrale e këtij procesi. Kërkesë për financim nga fondi social, shpenzime shuma 8.156.000 lekë.

Kërkesën për financim nga fondi social për "Shoqaten Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë së Misionarëve të Dashurisë Kontemplative Vllaznitë e Nanë Terezës" me seli Bushat bashkia Vau Dejes. Ofron shërbim të përkujdesit shoqërorë për personat me aftësi të kufizuar të grup moshës 18-60 vjeç, ku përkujdeset për 32 persona me aftësi të kufizuar duke zvogëluar braktisjen dhe mospërfshirjen sociale të kësaj shtrese. Kjo qendër rrezidenciale ofron për këto persona mbështetje sociale, aktivitet kreativ, shërbime shëndetësore. Kërkesë për financim nga fondi social, shpenzime shuma 8.986.000 lekë

Përfshirja në jetën social-kulturore të moshës së tretrë:

Ky projekt synon që të përfshijë në jetë social-kulturore subjektet e rrezidencave publike të kësaj kategorie.

- Dita Botërore e të moshuarve 1 Tetor
- Fuqizimi dhe mbulimi me internet I të gjithë hapësirës së godinës së shtëpisë të moshuarve
- Ekskursion në Reç Malësi e madhe
- Ekskursion Shengjin

Vlera totale projektit 160.000 lek

Integrim I personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë:

-Realizimin e aktivitetit të një ndeshje basketbolli dhe ndeshje hendbolli.

-Në kuader të ditës së peshkimit disa prej burrave dhe djemve të realizojnë një ditë ndryshe peshkimi pranë liqenit.

-Organizimin e kampionatit të shahut mes antarëve të kësaj shoqate.

Vlera totale projektit 70.000 lekë.

Mbështetje e Shoqatës së të Verbërve.

Këshilli i Qarkut Shkodër çdo vit pikes 12 VKM nr.277 date 19.06.2023, financon Shoqaten e të Verbërve të Shqipërisë Dega Shkodër në vlerën prej 200.000 lekë.